



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**  
**"HAXHI ZEQA"**

Ref. Nr.1787/26

Pejë, 29.06.2026

Senati i Universitetit "Haxhi Zeqa" në Pejë në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 102, të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me 21.05.2026 dhe në bazë të vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Ref. Nr.01/2299 të datës 01.06.2026, miratojë propozimet e njëjësive akademike për shpalljen e:

**KONKURSI**  
**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve postdiplomike-Master për vitin**  
**akademik 2026/2027**

• **Fakulteti i Biznesit**

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
MMB	Menaxhim Biznesi MSc.– gjuhë shqipe MSc.	100	83	12	5
MMBb	Menaxhim Biznesi MSc. – gjuhë boshnjake MSc.	20	17	2	1
MBNJ	Menaxhim i Burimeve Njerëzore MSc.	80	66	10	4

IB	Informatikë në Biznes MSc.	60	50	7	3
MRS	Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet MSc.	25	21	3	1

**Modulet e studimit në programin Menaxhim Biznesi janë:**

1. Menaxhim Biznesi
2. Banka dhe Financa

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për Programin Menaxhim Biznesi në lëndët:**

- Bazat e Menaxhmentit dhe
- Hyrje në Biznes.

**Për Programin Menaxhim i Burimeve Njerëzore në lëndët:**

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe
- Menaxhmenti Strategjik.

**Për Programin Informatikë në Biznes në lëndët:**

- Bazat e Informatikës
- Biznesi Elektronik
- Sistemet Informative

**Për Programin Menaxhim i Riskut dhe Sigurime në lëndët**

- Bazat e Financës
- Menaxhimi i Riskut
- Ekonomia e Sigurimeve

- **Fakulteti Juridik**

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	
EDCB	E Drejta Civile dhe Biznesore, LLM	25	21	3	1
EDS	E Drejta dhe Siguria LLM	25	21	3	1

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për programin E Drejta Civile dhe Biznesor**

- E drejta Civile
- E drejta e Procedures Civile
- E drejta Tregtare

**Për programin E Drejta dhe Siguria**

- E Drejta Kushtetuese
- Siguria kombëtare

- **Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis**

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
MTQ	Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm MSc.	25	21	3	1
MMT	Menaxhimi i Marketingut Turistik MSc - Gjuhë shqipe	25	21	3	1
MMTB	Menaxhimi i Marketingut Turistik MSc - Gjuhë boshnjake	20	17	2	1

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për programin Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm në lëndët:**

- Hyrje në Turizëm
- Ekonomia e Turizmit dhe Biznesi

**Për programin Menaxhimi i Marketingut Turistik në lëndët:**

- Menaxhimi strategjik i marketingut turistik
- Komunikimi i integruar i marketingut

- **Fakulteti i Agrobiznesit**

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
SPQU	Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor MSc.	25	21	3	1
MM	Menaxhim Mjedisi MSc.	20	17	2	1

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për Programin Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor në lëndët:**

- Hyrje në Teknologjinë e Ushqimit
- Kimia (ushqimore, organike, analitike).
- Mikrobiologjia Ushqimore dhe Higjiena.
- Proceset Themelore në Teknologjinë Ushqimore.

**Për programin Menaxhim Mjedisi në lëndët:**

- Kimi
- Biologji

- **Fakulteti i Arteve**

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
EM	Edukim Muzikor	5	3	1	1
AP	Art Performuese	10	8	1	1

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për programin Edukim Muzikor në lëndët:**

- Pedagogji Muzikore (Metodika e mësimdhënies së muzikës)
- Harmoni (Detyrë Harmonike për formacionin S,A,T,B a. Harmonizimi i sopranit b. Harmonizimi i basit, detyra zhvillohet deri në alteracione)

**Për programin Arte Performuese në lëndet:**

- Instrumenti përkatës:  
Një vepër virtuoze  
Një vepër ciklike (koha e pare / pjesa e pare)  
Një vepër e lire .  
Për Solo këndim:  
Një vepër accapela  
Një vepër shqipe  
Një vepër nga epoka e romantizmit

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në studimet postdiplomike-Master, për vitin akademik 2026/2027 do të regjistrojë **465** studentë.

2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi duke u bazuar në UA Nr.09/2016 të MASHTI, Universiteti do të regjistrojë deri në 12% studentë të rregullt, përkatësisht **55** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studenteve për secilin program të fakulteteve veç e veç.

3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të regjistrohen deri në 5%, përkatësisht deri në **23** kandidatë nga: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja dhe Mali i Zi. Kandidatët, të cilët kanë lindur në vendet e sipërhënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.

### I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT

1. Në studimet postdiplomike-Master në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët, të cilët i kanë mbaruar studimet themelore – Bachelor në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

2. Të drejtë pranimi në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në rastet e tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet themelore jashtë Kosovës me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'i kenë të nostrifikuara diplomatat e përfundimit të studimeve themelore. Kandidatë jo kosovarë llogariten të gjithë ata kandidatë që nuk janë shtetas të Kosovës. (Vendimi për njohje/nostrifikim të diplomave lëshohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës).

3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet Master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve i njësisë akademike cakton provime diferenciale, të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në rastet e tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve diferenciale në afatin e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale, të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.

4. Përjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vete njësitë akademike.

5. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër

studimi në UHZ pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.

6. Kandidatët të cilët aplikojnë në këtë konkurs për pranim si student në vitin akademik 2026/2027 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.

2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.

4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.

5. Për funksionimin e programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.

## III. AFATET KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **01.07.2026** deri më **14.07.2026** nga ora 09:00 - 15:00 (e hënë – e premte)
2. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:
  - Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku) për aplikim Online përmes Internetit është: <http://apliko.unhz.eu>
  - ekstraktë/certifikatë e lindjes (origjinal),
  - diplomën origjinale, ose të noterizuar, përkatësisht certifikatën e diplomës – origjinal ose të noterizuar,
  - dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në institucionet private të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës).

3. Provimi pranues do të mbahet me **15.07.2026** sipas orarit si në vijim:

- Fakulteti i Biznesit me **15.07.2026** në ora 12:00
- Fakulteti Juridik me **15.07.2026** në ora 12:00
- Fakulteti i MTHM me **15.07.2026** në ora 12:00
- Fakulteti i Agrobiznesit me **15.07.2026** në ora 12:00
- Fakulteti i Arteve me **15.07.2026** në ora 12:00

4. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë njërin nga këto dokumente identifikuese: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shofer, pa njërin nga të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

5. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues bëhet më **17.07.2026**.

#### **IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË**

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve Master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve në fakultetet përkatëse pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni i ankesave në Rektorat.

#### **V. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE DHE REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR**

1. Rezultatet përfundimtare në bazë të vendimit të komisionit të ankesave shpallen më së largu deri më **27.07.2026**.
2. Regjistrimin dhe fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet më **29.07.2026 dhe 30.07.2026** për të gjitha fakultetet prej orës 09:00 deri 15:00 në ndërtesën e Fakultetit Juridik
3. Kandidatet e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili gjenerohet me rastin e fotografimit në Administratën Qendrore të UHZ-ës, aty ku bëhet regjistrimi)
4. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më 09.11.2026, në ora 15:00. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.**